REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SË LIRISË

Nr.____prot **Tiranë ___Nëntor, 2027**

DREJTUAR: KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

AMENDAMENT: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të neneve 71 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, Grupi Parlamentar i Partisë së Lirisë, kërkon:

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

NENI 1

Në Tabelën e shpenzimeve të Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, totali i Shpenzimeve Korrente i Programit 10910 të Ministrisë së Mbrojtjes, Emergjencat Civile, të bëhet nga 1,559,905 ku 261,800 janë shpenzime për pagat, në **1,651,535**, që përfaqëson **një rritje prej 35 % të fondit të pagave.**

Në masën 35% të shtohen edhe pagesat për orët shtesë të punës, shpërblimet dhe dietat.

NENI 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Shqipëria po përballet çdo vit me një përkeqësim të ndjeshëm të situatës së emergjencave civile, veçanërisht të zjarreve në pyje, kullota, zona të banuara dhe territore me rëndësi të veçantë natyrore, ekonomike dhe kulturore.

Vit pas viti, zjarret janë shndërruar në një kërcënim të përsëritur për jetën e qytetarëve, pronën private, pasuritë publike dhe mjedisin.

Çdo sezon veror, vendi përballet me skena të përsëritura të zjarreve masive, me sipërfaqe të tëra pyjore dhe kullosore të përfshira nga flakët, me banesa dhe fshatra të rrezikuara, me dëme të konsiderueshme ekonomike dhe mjedisore. Në jo pak raste, ndërhyrjet bëhen në kushte tepër të vështira, kur zjarri ka marrë përmasa të mëdha dhe kur mungesa e kapaciteteve parandaluese dhe reaguese e bën shumë më të vështirë kontrollin e situatës.

Në këtë realitet, punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit janë ata që përballen drejtpërdrejt me pasojat e dështimeve të politikave shtetërore për parandalimin dhe menaxhimin e emergjencave. Janë zjarrfikësit ata që dërgohen në vijën e parë të luftës me flakët, që hyjnë në zonat më të rrezikshme, që punojnë në temperatura ekstreme, në terrene të vështira dhe shpesh pa asnjë garanci se do të dalin shëndoshë e mirë nga ndërhyrja.

Ata rrezikojnë jetën për të shpëtuar jetën e të tjerëve. Përballen me flakët për të mbrojtur shtëpitë dhe pronat e qytetarëve, qëndrojnë me orë dhe ditë të tëra në terren, pa dallim orari, fundjave apo festash, dhe angazhohen në operacione shpëtimi jo vetwm gjatw zjarreve, por edhe gjatë përmbytjeve, tërmeteve dhe fatkeqësive të tjera natyrore. Është një profesion që kërkon sakrificë të jashtëzakonshme fizike dhe psikologjike, përgatitje të vazhdueshme, disiplinë dhe gatishmëri absolute.

Por, ndërsa prej tyre kërkohet të japin maksimumin dhe të rrezikojnë gjithçka, qeveria nuk u garanton as trajtimin financiar që meritojnë. Zjarrfikësit vazhdojnë të jenë ndër kategoritë më të nënvlerësuara dhe të keqpaguar të shërbimit publik, pavarësisht rrezikshmërisë së lartë të profesionit dhe rëndësisë jetike të funksionit që kryejnë.

Kjo është një padrejtësi e rëndë dhe e pajustifikueshme. Është e papranueshme që punonjësve të cilëve shteti u kërkon të përballen me flakët, të hyjnë në terre të vështira apo

ndërtesa që digjen dhe të rrezikojnë jetën për të shpëtuar qytetarët, t'u mohohet një trajtim financiar dinjitoz.

Është po aq e papranueshme që sakrifica e tyre të kujtohet vetëm në ditët e emergjencave, ndërsa në hartimin e buxhetit të shtetit ata të mbeten sërish në fund të vëmendjes dhe prioriteteve qeveritare.

Në vend që t'i trajtojë zjarrfikësit si një aset strategjik të sigurisë publike dhe të mbrojtjes civile, qeveria i ka lënë të përballen me një realitet të vështirë, ku përgjegjësitë shtohen, rreziqet bëhen gjithnjë e më të mëdha, ndërsa vlerësimi financiar mbetet shumë larg sakrificës së tyre. Kjo është një formë braktisjeje institucionale ndaj njerëzve që nuk e braktisin kurrë detyrën e tyre, edhe në momentet kur jeta e tyre është në rrezik.

Keqpagimi i zjarrfikësve nuk është thjesht një problem social apo financiar. Ai ndikon drejtpërdrejt në motivimin e personelit, në aftësinë për të mbajtur punonjës të kualifikuar dhe me përvojë, në tërheqjen e profesionistëve të rinj dhe, për rrjedhojë, në cilësinë dhe efektivitetin e shërbimit. Një shërbim zjarrfikës i dobësuar në burime njerëzore dhe i demotivuar për shkak të trajtimit të padrejtë financiar përbën një rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e të gjithë qytetarëve.

Nuk mund të ketë mbrojtje civile funksionale pa njerëz të motivuar, të përgatitur dhe të vlerësuar. Nuk mund të pretendohet se siguria e qytetarëve është prioritet, kur ata që kanë për detyrë ta garantojnë atë përballen me paga të pamjaftueshme dhe me një mungesë të dukshme vlerësimi nga institucionet përgjegjëse.

Qeveria nuk mund të kujtohet për zjarrfikësit vetëm kur digjen pyjet, kur flakët u afrohen banesave apo kur qytetarët kërkojnë ndihmë. Përgjegjësia e shtetit është t'i mbështesë ata përpara se të shpërthejë emergjenca, t'u garantojë kushte dinjitoze pune, trajtim financiar të drejtë, pajisje dhe mjete të përshtatshme, si dhe sigurinë që u nevojitet për të përmbushur misionin e tyre.

Rritja e pagave të zjarrfikësve nuk është një favor që qeveria u bën këtyre punonjësve, por një detyrim ndaj njerëzve që çdo ditë mbajnë mbi supe një përgjegjësi jetike për shoqërinë. Nuk mund t'u kërkohet të jenë heronj në çdo emergjencë, ndërsa të trajtohen si të harruar kur vjen momenti për të vlerësuar punën dhe sakrificën e tyre.

Për këto arsye, nëpërmjet këtij amendamenti propozohet rritja me 35% e fondit të pagave për punonjësit e Programit 10910 të Ministrisë së Mbrojtjes, Emergjencat Civile, me qëllim

përmirësimin e ndjeshëm të trajtimit financiar të tyre, rritjen e motivimit dhe forcimin e qëndrueshmërisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Në masën 35% të shtohen edhe pagesat për orët shtesë të punës, shpërblimet dhe dietat.

Kjo rritje përfaqëson një hap të domosdoshëm për t'i dhënë fund një padrejtësie të zgjatur ndër vite dhe për të rikthyer dinjitetin e një profesioni që meriton respekt jo vetëm me fjalë, por mbi të gjitha me mbështetje konkrete buxhetore.

Një qeveri që nuk vlerëson ata që rrezikojnë jetën për të shpëtuar qytetarët, nuk mund të pretendojë se e ka sigurinë e tyre prioritet. Zjarrfikësit nuk kanë nevojë për duartrokitje kur shuajnë flakët. Kanë nevojë për një shtet që nuk i braktis kur janë jashtë vëmendjes së kamerave.
Rritja e pagave të zjarrfikësve është një domosdoshmëri për dinjitetin e tyre profesional, për sigurinë e qytetarëve dhe për forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes civile në vend.

DEPUTETËT PROPOZUES

Tedi Blushi **Erisa Xhixho**

Edmond Haxhinasto **Brunilda Haxhiu**